

METODOLOGJIA E PERCAKTIMIT TE TARIFES FIKSE TE ENERGIJE ELEKTRIKE TE PRODHUAR NGA CENTRALET ME PERPARESI QE SHFRYTEZOJNE BURIME TE RINOVUESHME ENERGIJE

1. Autoriteti

Metodologjia e llogaritjes së tarifës fikse për energjinë elektrike të prodhuar nga, impiantet që përdorin burimet e rinovueshme të energjisë është hartuar në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr. 138/2013 “PËR BURIMET E ENERGIJË SË RINOVUESHME”

2. Qëllimi

Kjo Metodologji ka për qëllim të përcaktojë parimet dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave fikse të energjisë elektrike, që do t'i paguhet prodhuesit me përparësi, për të gjitha llojet e centraleve, që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie me fuqi të instaluar deri në 15MW, (neni 15 pika 1)

3. Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

Bazuar në nenin 15.pika 2 , të Ligjit Nr. 138/2013 Kjo metodologji ka si parime themelore:

- a) të lejojë rikuperimin e investimeve të prodhuesit me një normë fitimi të arsyeshme;
- b) të marrë në konsideratë impaktin social dhe ekonomik, që do të rezultojë për konsumatorët fundorë nga zbatimi i skemës së tarifës fikse;

4. Ndarja e Tarifave ne perputhje me kapacitetin gjenerues

Me qellim qe kostot e prodhimit te energjise elektrike nga keto gjenerues te reflektojne ne menyre te drejte dhe te aresyeshme kostot reale te ketyre hidrocentraleve , vendosja dhe rishikimi I tarifave do te kryhet duke i ndarë ata në tre grupe :

- grupi i parë: nga 0 deri në 2000 kW,
- grupi i dytë nga 2001 deri në 5000 kW
- grupi i tretë nga 5001 deri në 15000 kW.

5. Kohezjtja e tarifes

Tarifa nxitese do te zbatohet per nje kohe mesatarisht 15 vjecare , :

- a. Per shoqerite prodhuese te energjise elektrike koncesionare duke filluar nga dita e futjes ne operim.
- b. Per shoqerite prodhuese te energjise elektrike te privatizuara kjo periudhe do te zbatohet per pjesen e mbetur te kohes nga dita e privatizimit ose nga koha e futjes ne operim te kapaciteteve shtese te miratuara nga ERE.

6. Rishikimi I Tarifes

Rishikimi apo korigjimi I tarifes mbi **baza vjetore** do te kryhet per qellim :

- Rishikim ex-post per diferencat ndermjet kostove te priteshme te pranuar ne llogaritjen e tarifes sipas formule dhe atyre aktuale /realizuara . Ky axhustim do te kryhet per shkak se formula bazohet ne te dhena dhe pranime per zera te ndryshme te kostove qe priten te realizohen e per pasoje te shmange te ardhurat e teperta qe mund te rezultojne .
- Axhustim i tarifes i lidhur me ndryshimet ne kapacitete.
- Axhustimi I komponenteve te tarifes per efekt te inflacion(germa ç pika 2 e nenit 15 te Ligjit 138/2013)

Ky rishikim do te realizohet Brenda muajit Shtator te vitit aktual per periudhen pasardhese.

7. LLOGARITJES SE TARIFES FIKSE

Ne zbatim të pikës 5, të nenit 15 të Ligjit nr.138/2013 “ Per Burimet e Energjise se Rinovueshme” për përcaktimin e tarifës fikse për secilën teknologji të burimeve të rinovueshme do të zbatohet formula e mëposhtme:

$$FIT = \frac{I}{FLH} \left(\frac{WACC}{1 - \frac{1}{(1+WACC)^T}} \right) + \frac{c_F}{FLH} + c_V \quad [Lek / MWh]$$

- ❖ “Fit” - janë çmimet e energjisë elektrike të shitjes (tarifat fikse), duke përdorur burimet e energjive të rinovueshme (lekë/MW) për secilin nga tre grupet e përcaktuara në pikën 4 të kësaj metodologjie.

Tarifa fikse do të llogaritet mbi bazën e të dhënave teknike dhe financiare (Pasqyrat financiare të certifikuar nga eksperti i pavarur) vetëm për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të tre viteve të fundit .

- ❖ “I” është kostoja mesatare specifike e investimeve (lekë/MW) për secilin nga tre grupet e sipërpërmendura, që përcaktohet nga ERE çdo tre vjet.

Ky tregues do të reflektojë Investimet e kryera nga shoqëria që kanë lidhje direkte me aktivitetin e licensuar për prodhimin e energjisë elektrike.e në mënyrë të detajuar:

- *Vlerën totale të investimit / asetëve , koston historike të asetëve që I shërbejnë vetëm aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike , sipas Pasqyrave Financiare të vitit kur shoqëria ka hyrë në operim .*
- *Investimet shtese për rritje kapaciteti.*
- *Vlera e asetëve që nuk janë në operim.*

- *Per centralët që janë akoma në ndërtim vlera e investimit do të jetë ajo e aprovuar nga MEI sipas projektit zbatimit.*

- ❖ “FLH” janë orët mesatare të punës me fuqi maksimale në vit (orë për vit) për secilin nga tre grupet e sipërpërmendura;

Per këto duhet të prezantohet nga shoqëritë dokumenta justifikuese që lidhen me :

- Energjinë elektrike vjetore totale të prodhuar për një periudhë 12 mujore
- Fuqinë e instaluar të Centraleve të shoqërisë.
- Te dhënat që rezultojnë nga Dokumentacioni i mbajtur në central.
- *Per centralët që priten të hyjnë në operim deri në fund të vitit ky tregues do të merret nga studimi i realizueshmërisë I paraqitur në dokumentat e marrjes së koncesionit.*

- ❖ “WACC” është norma mesatare e ponderuar e kostos së kapitalit, që merr parasysh normat mesatare të huasë në tregun shqiptar, normën e interesit/ kthimit të kapitalit të vet si dhe strukturën e kapitalit (equity/hua) që përcaktohet nga ERE çdo tre vjet, sipas formulës në vijim:

$$\text{WACC} = \frac{\text{debt \%} \times \text{interest rate \%} + \text{equity \%} \times \text{ROE \%}}{100}$$

Ku:

| | |
|------------------------|---|
| Debt % | është raporti i përcaktuar nga ERE për borxhin në % |
| Interest rate % | është norma mesatare e interesit të huasë në %... |
| Equity % | është raporti i përcaktuar nga ERE për kapitalin në % ... (equity%=100% - debt%) |
| ROE % | është norma e interesit/kthimit mbi kapitalin e vet. |

ERE do të miratojë një normë fikse të kthimit të kapitalit e cila do të llogaritet si një përqindje mbi vlerën e përgjithshme të investimeve të kapitalizuara për marrëveshjet 15 (pesëmbëdhjetë) vjeçare të blerjes,

Norma e kthimit mbi kapitalin e vet (ROE) do të mundesoje kthimin e kostos së kapitalit për një afat 15 vjeçar.

Norma e interesit e pranuar për borxhin do të jetë norma aktuale e interesit të aplikueshem sipas termave të marrëveshjes së huasë midis institucioneve financiare/huadhenesë dhe këtyre shoqerive, por jo më lartë se sa norma e interesit të kredive për bizneset e mëdha për një periudhë afatgjatë (me shumë se 5 vjet)

Leva financiare, (edhe më sipër përmendëm)do të pranohet që raporti i borxhit kundrejt kapitaleve të veta në vlerën totale të investimit të jetë ndërmjet **(60% - 70%)** **që do të rezultojë nga raporti faktik.**

- ❖ “T” është kohëzgjatja e çmimit të garantuar, në vite (15 vite për prodhuesit me përparësi) sipas pikës 5 të kësaj Metodologjie .
- ❖ “CF” janë kostot mesatare specifike të operimit dhe menaxhimit (lekë/MW/vjet) për secilin nga tre grupet e sipërpërmendura, që përcaktohet nga ERE-ja çdo tre vjet, që kanë lidhje direkte me aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Në këto kategori do të përfshihen kostot materialeve ,pjesëve të këmbimit apo mirëmbajtje të tjera , kostot e personelit, ujit, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera si kosto të sigurisë apo taksa lokale apo ndonjë shpenzim tjetër që lidhet me drejtimin?

Kostot e personelit ; do të përcaktohen sipas :

- Kostove reale të shoqeruara me dokumenta justifikues

Ose :

- Normave (benchmark-ut) për central e që kanë të njëjtin fuqi të instaluar.

Ose:

- *Do te llogaritet si n je kosto mesatare midis shpenzimit per paga per centarlin me kapacitet me te vogel 0.07 MW e dhe centralit me kapacitet te instaluar me te madh qe rezulton14.2 MW.*

Kostot e mirembajtjes ; do te percaktohen bazuar ne kostot reale qe rezultojne nga te dhenat e certifikuar te 3 viteve te fundit ,

Ose ;

Bazuar ne eksperincat e centraleve te ngjashme kosto e mirembajtjes do te llogaritet duke konsideruar si 1.5% e vleres se investimit dhe mund te konsiderohen si konstante per vitet ne vazhdim.

Kostot e ujit ; te percaaktohet bazuar ne pagesat reale qe hidrocentralet paguajne .
(sipas detyrimeve te percaktuara ne Aktet ligjore?)

- ❖ “CV” janë kostot mesatare të lëndës djegëse dhe kostot e tjera të ndryshueshme të menaxhimit (që përdoret si term vetëm për centrale me dy lëndë djegëse që përdorin edhe një sasi të vogël lënde djegëse për stabilitetin e flakës) (lekë/MWh), për secilin nga tre grupet e sipërpërmendura, që përcaktohet nga ERE çdo tre vjet.

8. Detyrimet e kompanive

Të gjitha subjektet, që prodhojnë energji nga burimet e rinovueshme, janë të detyruara që, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, të paraqesin pranë ERE-s dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore bilancin vjetor të një viti më parë.

Po ashtu keto subjekte duhet te paraqesin ne ERE **deri me 15 Prill te vitit aktual** te dhenat per tregues te ndryshem teknik ekonomik e financiar te nevojshme per zbatimin e formule llogaritese te tarifes fikse sipas Anexit Nr.1, pjese perberese e kesaj metodollogjije.

Te gjitha te dhenat si me siper duhet t'i perkasin vetem aktivitetit te prodhimit te energjise elektrike gje qe ka si kusht themelor mbajtjen e llogarive te ndara te ketij aktiviteti nga te gjitha aktivitetet e tjera te saj.

9. Procedura per rishikimin periodik te tarifave

Tarifat fikse do te rishikohen mbi baza vjetore ne perputhje me rregullat dhe praktikat e ERE-s

10. Dispozita përfundimtare

Metodologjia e llogaritjes se çmimit unik per energjine elektrike te prodhuar nga HEC-et me perparesi me e fuqi te instaluar deri ne 15 MW, te dhene me konçesion wshw hartuar nw zbatim tw nenint 15 pika 1 tw ligjit 138 /2013 dhe hyn nw fuqi vetwm pas publikimit nw fletore zyrtare tw vendimit tw miratimit nga Kwshilli I Ministrave.

ANEX I.

| Parametrat | Te dhenat e kerkuara | Viti I meparshem | Viti aktual |
|-------------------|--|------------------|-------------|
| Parametrat Teknik | Statusi i HEC-it | | |
| | Renia neto (m) | | |
| | Prurja Llogaritese (m3/sek) | | |
| | Fuqja e Centralit (kW) | | |
| | Fuqja sipas Kontrates se Koncesionit (kW) | | |
| | Energjia elektrike vjetore prodhuar/llogaritur (kWh/vit) | | |
| | Energjia elektrike vjetore sipas Kontrates se Koncesionit (kWh/vit) | | |
| | Oret vjetore te punes me kapacitet te plote te centralit | | |
| | Emri dhe shteti nga te cilat jane furnizuar pajisjet elektromekanike | | |
| | Niveli i tensionit (kV) te lidhjes se HEC-it me rrjetin elektrik | | |

| Parametrat | Te dhenat e kerkuara | Viti I meparshem | Viti aktual |
|-----------------------|--|------------------|-------------|
| Parametrat Financiare | Perqindja e Investimeve te kryera nga kompania (%) | | |
| | Perqindja e Investimeve te kryera me hua te marre nga bankat (%) | | |
| | Norma e Interesit te huase (%) | | |
| | Investimet totale sipas Kontrates se Koncesionit (mil/ALL) | | |
| | Asetet sipas bilancit | | |
| | Investimet te realizuara deri me tani (kosto historike) (mil /ALL) | | |
| | OPEX Total (mil leke) | | |
| | Shpenzime Mirembajtje | | |
| | Kosto materjale | | |
| | Shpenzime Paga/shtesa/sigurime | | |
| | Kostat e kontrollit dhe monitorimit | | |
| | Te tjera (te detajuara ne zera analitik) | | |